

**RAPORTI I KE-së PËR KOSOVËN PËR VITIN 2020 PËR SHOQËRINË CIVILE: KORNIZË POZITIVE  
LIGJORE DHE E POLITIKAVE, POR NGECJE NË ZBATIM****Financimi publik për OShC-të dhe qasja në shërbime bankare mbesin ndër sfidat më të mëdha për  
punën e shoqërisë civile në Kosovë***Bruksel, Prishtinë – 8 tetor 2020*

Me pak vonesë për shkak të pandemisë Covid-19, dje Komisioni Evropian publikoi Raportin e vitit 2020 për Kosovën. Pjesa për Kriteret Politike, përfshinë, ndër të tjera, edhe një vlerësim të çështjeve kryesore për shoqërinë civile dhe ambientin e funksionimit të këtij sektori. KCSF-ja vëren se Raporti i këtij viti i KE-së ka marrë parasysh pjesën më të madhe të çështjeve të ngritura nga KCSF-ja dhe kryesisht është pasqyrim real i gjendjes së ambientit për zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë.

Raporti i KE-së thekson se shoqëria civile luan rol aktiv dhe vendimtar në promovimin e të drejtave qytetare, politike, ekonomike, sociale e kulturore dhe këtë e bën kryesisht pa presion të panevojshëm nga autoritetet e Kosovës. Përparimi më i madh është shënuar në miratimin e një sërë dokumentesh ligjore e strategjike, si miratimi i **Ligjit për Lirinë e Asociimit në OJQ (Ligji i OJQ-ve)** në prill të vitit 2019, dhe **Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2019-2023** në shkurt të vitit 2019. Ndërsa këto të dyja janë dokumente shumë të rëndësishme për funksionimin e shoqërisë civile në Kosovë, KCSF-ja rikujton se këto dy dokumente janë shoqëruar me sfida serioze. Ligji për OJQ-të u korrigjua në prill të vitit 2019 vetëm pasi që Kuvendi kishte miratuar më parë një ligj shumë kufizues dhe pas një fushate intensive avokimi të shoqërisë civile, ndërsa zbatimi i tij po ngec nga vonesat e paarsyeshme në hartimin dhe miratimin e legjislacionit sekondar. Nga ana tjetër, Strategjia e Qeverisë për bashkëpunim me shoqërinë civile vazhdon të vuajë nga mungesa e vullnetit politik dhe e burimeve financiare e njerëzore të dedikuara për zbatimin e saj

Përparim është vërejtur edhe në **konsultimet publike në nivel qendror**, për të cilat Raporti me të drejtë vlerëson se po bëhen më të rregullta, pasi mbi 82% e të gjitha dokumenteve primare të politikave dhe projektligjeve u publikuan për konsultim në ueb portal gjatë vitit 2019. Megjithatë, Raporti shton se standardet minimale për konsultime publike nuk po zbatohen në mënyrë të vazhdueshme. Qasja më e lehtë në të dhëna dhe përgjigjet më të rregullta nga autoritetet publike, si dhe vetëdijesimi dhe promovimi i platformave konsultative janë vënë re si elemente që duhet të përmirësohen. Përveç kësaj, monitorimi i rregullt nga KCSF-ja i procesit të konsultimit publik tregon se konsultimi online me shkrim në fund të procesit të hartimit është pothuaj e vetmja mënyrë e konsultimit, që nuk është as në kohë të duhur dhe as i përshtatshëm për të siguruar që konsultimet publike janë efektive.

Fusha në të cilën janë vërejtur më së shumti sfida është **fondet publike për OSHC-të**, ku autoritetet qendrore e lokale janë vlerësuar që kanë kapacitete të kufizuara për t'i zbatuar drejtë standardet e reja të transparencës dhe llogaridhënies, duke paraqitur kështu rrezik për korrupsion dhe konflikt të interesit. Raporti gjithashtu kërkon që informatat rreth fondeve publike për OShC të jenë lehtë të qasshme dhe publike. Vrojtimit e KCSF-së konfirmojnë se një situatë e tillë mbretëron në të gjitha institucionet publike, në të gjitha nivelet, ndërsa sa u përket shumave dhe natyrës së financimit, të dhënat aktuale që publikohen nga Qeveria çdo vit mbeten të pasigurta dhe çorientuese.

KCSF-ja është shumë e lumtur të shohë që Raporti përmend **qasjen e OShC-ve në shërbime bankare**, të cilat ballafaqohen me kufizime në Kosovë. Një çështje e tillë është identifikuar nga KCSF-ja dhe OShC-të e tjera si një prej ngarkesave më të mëdha në punën e përditshme të shoqërisë civile dhe duhet të adresohet urgjentisht. Raporti cek edhe nevojën për ta përditësuar **vlerësimin e rrezikut sektorial për pastrim së parave dhe financim të terrorizmit nga sektori i OShC-ve** për të lejuar qasje fleksibile për OShC-të me rrezik më të ulët, një qasje që KCSF-ja e ka kërkuar që nga viti 2013.

E fundit, por jo më pak e rëndësishmja, raporti ripohon nevojën për procedura më transparente dhe më mirë të harmonizuara për **ofrim të shërbimeve publike nga OShC-të**, një regjim të favorshëm tatimor për



A. Musa Tolaj, Nartel Center, Llam. A, H-1,  
Kati 12, nr. 65-1, Prishtinë, Kosovë.  
T. +383 38 600 633, +383 38 600 644  
E. [office@kcsfoundation.org](mailto:office@kcsfoundation.org)  
W. [www.kcsfoundation.org](http://www.kcsfoundation.org)

**filantropinë individuale dhe të korporatave**, kritere dhe procedura standarde për **ndarjen e pronës publike**, si dhe **promovimin e vullnetarizmit** përmes programeve të dedikuara, standardeve dhe praktikave të mira.

Komisioni Evropian e njeh **rolin vendimtar të shoqërisë civile** jo vetëm në ndërtimin e demokracisë në përgjithësi, por edhe në sektorë të veçantë, si të drejtat e grave dhe barazia gjinore, pajtimi, të drejtat e komunitetit LGBTI, mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve, mbrojtja e mjedisit dhe llogaridhënia e qeverisë.

Megjithatë, Raporti mbetet i **heshtur në çështjet që lidhen me mos-përfshirjen e shoqërisë civile në agjendën e BE-së**, sidomos në mungesën e zbatimit të **Udhëzimit mbi konsultimet me organizatat e shoqërisë civile dhe hisedarët tjerë në kuadër të trupave të Stabilizim Asocimit BE – Kosovë**. Edhe pse ky Udhëzim është në fuqi nga shkurti 2018, deri më tani nuk është duke e përmbushur qëllimin për çka është krijuar, për shkak që OShC-të mbesin të painformuara mbi këtë mekanizëm dhe kanë mundësi shumë të pakta që ta shfrytëzojnë si kanal për kontribut në zbatimin e MSA-së.